



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 237, datë 02.06.2021

PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR TË VLERËSIMIT ETIK DHE
PROFESIONAL VITI KALENDARIK 2019, PËR GJYQTARËT QË KANË
PLOTËSUAR KRITERET LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJE NË DETYRË
DHE QË KANË USHTRUAR DETYRËN E NDIHMËSMAGJISTRATIT NË
GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 97 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 61, pika 1, nenin 63 dhe nenin 86, shkronja “dh”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 194, datë 12.05.2021 “Rregullat e vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Gjykatën e Lartë”, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.70 datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, pas verifikimit të kriterëve të kandidimit për gjyqtarët që kanë ushtruar detyrën e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë dhe kanë aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatat e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm, Gjykatën Administrative të Apelit dhe Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe pas shortit të realizuar,

VENDOSI:

- I. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë ushtruar detyrën e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë dhe kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatat e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm, Gjykatën Administrative të Apelit dhe Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
- II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:
 1. Për gjyqtarin z. {...}- Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Zeta Tërpollari.
 2. Për gjyqtarin z. {...}- Relator znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR